



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 4362 Prot.

(Lutemi referojuni në rast përgjigjeje)

Tiranë, më 06.11.2020

**URDHËR**

Nr. 108, Datë 06/11/2020

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR MATURËN SHTETËRORE DHE MATURËN  
SHTETËRORE PROFESIONALE 2021**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ**

1. Miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore 2021, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Rezana VRAPI  
DREJTOR I PËRGJITHSHEM

Referenca Urdhri nr. __, datë __. __.2019 “Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore”	Periudha/Datat
<b>Kreu II</b> <b>Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të maturës</b>	
Neni 7, shkronja “o”	Dërgon në QSHA, brenda datës <b>19 shkurt 2021</b> , listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.
Neni 8, shkronja “m”	Plotëson brenda datës <b>30 prill 2021</b> , bazën e të dhënave për maturanët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturan/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturan/kandidati, të vulosura dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.
Neni 8, shkronja “n”	Plotëson në periudhën <b>8 – 19 qershor 2021</b> , bazën e të dhënave për maturanët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.
Neni 8, shkronja “p”	Në periudhën <b>21 – 26 qershor 2021</b> përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem.
<b>Kreu IV</b> <b>Aplikimi për provimet e maturës</b>	
Neni 13, pika 2	Maturan/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania në periudhën <b>16 nëntor – 10 dhjetor 2020</b> , dhe më pas, në portalin “Matura Shtetërore 2021”, në periudhën <b>17 nëntor – 10 dhjetor 2020</b> . Aplikimi në portalin “Matura Shtetërore 2021”, bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA.
Neni 13, pika 3	KSHMSH-ja, deri më datë <b>17 dhjetor 2020</b> afishon në shkollë, një kopje të bazës së të dhënave, të shkarkuar nga portali i Maturës Shtetërore dhe pret vërejtjet e maturanëve/kandidatëve për korrigjime të mundshme në bazën e të dhënave të regjistruara në portalin “Matura Shtetërore”. Brenda datës <b>15 janar 2021</b> , KSHMSH-ja bën verifikimet dhe korrigjimet përkatëse në sistem.